

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR “NASTO & BRIJA
LEGAL” SH.P.K**

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Sot me date 22.01.2024 në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, me vullnet të lirë Themeluesit e Shoqërisë “Nasto & Brija Legal” sh.p.k:

- 1. Ted Nasto** i biri i Kristaq lindur ne Vlore me 23-06-1980 dhe banues ne Tirane, identifikuar në bazë të dokumentit Leternjoftim ID nr. 034072237 me nr. Personal **I00623197S** madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,
- 2. Samidie Brija e** bija e Gani lindur ne Kukes me 09-12-1985 dhe banuese ne Tirane, identifikuar në bazë të dokumentit Leternjoftim ID nr. 036293467 me nr. Personal **I56209055N** madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

si themeluesë te kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosen të hartojne këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

**NENI 2
EMRI**

Emri i shoqërisë është “**Nasto & Brija Legal**” shpk.

**NENI 3
FORMA**

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortaket do të përballojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.

**NENI 4
SELIA**

Shoqëria e ka seline e saj në adresen: Rruga Sami Frasheri, pallati nr. 11, Shkalla 2, Kati i 2, Apartamenti 1, Njesia Bashkiake nr. 5, Tirane.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 5
KOHEZGJATJA**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pa caktuar.

**NENI 6
OBJEKTI**

Shoqëria ka për objekt të saj, duke përfshirë por pa u kufizuar në: Kryerjen e shërbimeve të Avokatise dhe shërbimeve ligjore të tjera si: Përfaqësim ligjor dhe gjyqësor, hartimin e dokumentacionit ligjor në lidhje me përfaqësimet ligjore dhe gjyqësore, përgatitja e kërkesë

padive ose kërkesave gjatë procedimit gjyqësor, si dhe e kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore të të gjitha shkallëve të Gjyqësorit, përgatitja e ankesave dhe kërkesave të personave fizik ose juridik, përpilimi i akteve që i nënshtrohen veprimeve noteriale, hartimi i kontratave e marrëveshjeve, si dhe i çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike, përfaqësimi i personave fizik ose juridik në çështjet civile dhe administrative, në Gjykatë, në Arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike. Veprime të tjera ndihmëse juridike, si ndermjetesimin, keshillimin juridik si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike të parashikuar në ligj.

NENI 7 KAPITALI

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njqinde mije) Leke i ndare në dy pjese.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara dhe nënshkruar si më poshtë:

1. **Ted Nasto** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabartë me vlerë prej 50.000 (pesdhjete mije) lekë në kapitalin themeltar.
2. **Samidie Brija** në cilësinë e ortakut themelues zotëron 50% të kapitalit themeltar ose 1 kuotë të barabartë me vlerë prej 50.000 (pesdhjete mije) lekë në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërisë do të shlyhet teresish brenda 1 (nje) muaji nga themelimi i shoqërisë dhe do të depozitohet në një llogari bankare të hapur në emër të Shoqërisë në një nga bankat e nivelit të dyte.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjëherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

NENI 8 ORGANET E SHOQËRISË

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Shoqëria mund të emerojë me shumë se një administrator. Veprimet e të cileve do jënë njëlojë të vlefshme sikur meren bashkarisht ashtu edhe kur meren vec e vec. Në çdo rast, kur termi 'Administrator' përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërisë 'Nasto & Brija Legal' sh.p.k. ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj, sado qofshin këta në numër.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese do të rregullohet sipas ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe Statutin e shoqërisë.

NENI 9 ORGANI ADMINISTRATIV


Administrator i parë i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjetare është emruar **Z. Ted Nasto**, pajisur me leternjoftimin me nr. Leternjoftim ID nr. 034072237 me nr. Personal **I00623197S**

**NENI 10
DISPOZITAT E FUNDIT**

Ky akt themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje të njëjta në gjuhën shqipe duke patur secila kopje fuqi të njëjta ligjore.

THEMELUESIT

Ted Nasto



Samidie Brija

